


# Tregtia e jashtme e mallrave

## Prill 2018

**Tiranë, më 17 Maj 2018:** Në Prill 2018 eksportet e mallrave arritën vlerën 27 mld lekë, duke u rritur me 11,2 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe duke u ulur me 1,4 %, në krahasim me Mars 2018. Importet e mallrave arritën vlerën 52 mld lekë, duke u rritur me 4,9 %, në krahasim me një vit më parë dhe duke u ulur me 5,2 %, në krahasim me Mars 2018. Deficiti tregtar i këtij muaji është 26 mld lekë, duke u ulur me 0,9 %, krahasuar me Prill 2017 dhe me 8,9 %, në krahasim me Mars 2018.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në katër mujorin e parë të vitit 2018 eksportet e mallrave arritën vlerën 101 mld lekë, duke u rritur me 16,8 %, krahasuar me një vit më parë dhe importet e mallrave arritën vlerën 198 mld lekë, duke u rritur me 8,4 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 97 mld lekë, duke u rritur me 0,8 %, krahasuar me 2017.

**Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:**

Rritja vjetore e eksporteve prej 11,2 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +5,3 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me +2,0 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +1,7 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve kanë ndikuar negativisht grupet: “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me -0,4 pikë përqindje, “Lëkurë dhe artikuj prej tyre” me -0,1 pikë përqindje.

**Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Prill 2018**




Eksportet, gjatë këtij katërmujori janë rritur me 16,8 %, krahasuar me një vit më parë. Në ndryshimin vjetor të eksporteve nuk ka ndikuar negativisht asnjë grup. Grupet që kanë patur kontribut më të lartë në rritjen vjetore të eksporteve, janë: “Materiale ndërtimi dhe metale” me +4,5 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me +4,4 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +3,4 pikë përqindje.

**Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:**

Rritja vjetore e importeve prej 4,9 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +2,3 pikë përqindje, “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me +2,2 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me +1,9 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve ka ndikuar negativisht grupi: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -2,1 pikë përqindje.

**Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Prill 2018**



Si katërmujor, importet janë rritur me 8,4 %, krahasuar me katërmujorin 2018. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, janë: “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me +3,1 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +2,4 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me +0,9 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve ka ndikuar negativisht grupi: “Produkte kimike dhe plastike” me -0,01 pikë përqindje.

### **Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere**


Në muajin Prill 2018, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Prill 2017 janë: Italia me (9,7 %), Spanja me (6,6 %) dhe Serbia me (133,8 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Kosova me (-10,6 %), Greqia me (-1,7 %) dhe Kina me (-69,6 %).

Gjatë këtij katërmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia me (6,5 %), Spanja me (90,6 %) dhe Gjermania me (30,4 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Kosova me (-4,3 %), Kina me (-27,0 %) dhe Maqedonia me (-2,8 %).

Në muajin Prill 2018, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Prill 2017 janë: Turqia me (10,5 %), Kina me (5,9 %) dhe Rumania me (142,5 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia me (-1,7 %), Greqia me (-4,8 %) dhe Gjermania me (-4,5 %).

Gjatë këtij katërmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia me (4,3 %), Gjermania me (6,2 %) dhe Turqia me (8,7 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Serbia me (-18,7 %), Spanja me (-4,1 %) dhe Egjipti me (-18,8 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Prill 2018



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE zënë 65,7 %, të gjithë tregtisë. Në Prill 2018, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 72,9 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 62,1 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (35,1 %), Greqia (6,5 %), Gjermania (6,4 %) dhe Turqia (5,9 %).

Shkëmbimet tregtare, për katërmujorin e parë 2018, me vendet e BE zënë 67,7 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Prill 2018, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 78,3 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 62,3 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (35,6 %), Gjermania (7,3 %), Greqia (6,8 %) dhe Kina (5,8 %).

**Tab. 1 Qarkullimi i mallrave**

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2016	01-16	16	-7,8	35	-1,0	-18	47,0
	02-16	18	-4,4	42	7,6	-24	42,0
	03-16	19	-12,7	47	5,6	-28	41,2
	04-16	21	1,7	52	19,0	-31	40,7
	Janar – Prill 2016	74	-5,9	176	8,2	-101	42,4
2017	01-17	19	15,6	35	0,9	-16	53,8
	02-17	20	14,2	44	5,1	-24	45,7
	03-17	24	22,0	54	14,9	-30	43,8
	04-17	24	13,7	50	-3,9	-26	48,1
	Janar – Prill 2017	87	16,4	183	4,2	-96	47,3
2018	01-18	24	24,4	45	27,5	-21	52,5
	02-18	24	18,8	46	4,4	-22	52,0
	03-18	27	14,6	55	2,5	-28	49,0
	04-18	27	11,2	52	4,9	-26	51,0
	Janar – Prill 2018	101	16,8	198	8,4	-97	51,0

**Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë)**

	Eksporte				Importe			
	Prill-17	Prill -18	Jan.- Prill . 2017	Jan.- Prill.2018	Prill-17	Prill -18	Jan.- Prill . 2017	Jan.- Prill.2018
<b>Vendet e BE-së</b>	<b>17.335</b>	<b>19.461</b>	<b>66.421</b>	<b>79.247</b>	<b>31.858</b>	<b>32.531</b>	<b>114.170</b>	<b>123.704</b>
Austri	197	94	491	589	516	661	1.605	2.054
Mbretëri e Bashkuar	22	81	93	239	396	558	1.586	1.752
Gjermani	1.011	1.141	3.646	4.755	4.124	3.938	16.049	17.037
Greqi	1.123	1.103	3.862	4.464	4.217	4.014	14.587	15.873
Itali	11.617	12.745	47.402	50.487	15.302	15.038	53.826	56.153
Spanjë	1.521	1.622	4.205	8.016	1.066	901	3.743	3.588
Kroaci	62	71	213	254	303	467	1.208	1.959
Të tjera të BE-së	1.782	2.602	6.510	10.442	5.935	6.954	21.565	25.287
Kinë	1.323	403	3.838	2.804	3.001	3.179	13.562	14.666
Kosovë	2.033	1.819	6.139	5.877	712	764	2.309	2.377
Maqedonia	780	828	2.408	2.341	742	841	2.432	2.608
Rusi	26	5	32	10	1.175	740	3.066	3.224
SHBA	175	382	880	1.691	676	1.017	2.940	3.297
Turqi	166	90	648	444	4.144	4.579	15.043	16.359
Ukrainë	31	15	202	76	266	138	1.116	679
Zvicër	319	979	603	1.744	502	502	2.844	3.424
Të tjera	1.834	2.723	5.495	6.980	6.875	8.112	25.596	28.092
<b>Gjithsej</b>	<b>24.021</b>	<b>26.704</b>	<b>86.667</b>	<b>101.215</b>	<b>49.952</b>	<b>52.402</b>	<b>183.077</b>	<b>198.430</b>

**Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë)**

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Prill-17	Prill -18	Jan.- Prill . 2017	Jan.- Prill.2018	Prill-17	Prill -18	Jan.- Prill . 2017	Jan.- Prill.2018
<b>Gjithsej</b>	<b>24.021</b>	<b>26.704</b>	<b>86.667</b>	<b>101.215</b>	<b>49.952</b>	<b>52.402</b>	<b>183.077</b>	<b>198.430</b>
Ushqime, pije, duhan	2.608	2.981	7.454	8.984	8.885	8.946	31.877	33.491
Minerale, lëndë djegëse, en.el.	4.949	6.228	16.895	19.856	4.110	5.256	16.530	20.954
Produkte kimike dhe plastike	480	509	1.438	1.686	7.254	8.188	27.695	27.683
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	231	202	867	932	1.821	1.849	5.393	6.192
Prodhime druri dhe letre	598	715	2.390	2.862	1.971	2.012	6.761	7.177
Tekstile dhe këpucë	9.392	9.881	37.613	41.415	7.072	7.249	26.230	27.959
Materiale ndërtimi dhe metale	3.751	4.154	13.481	17.373	7.037	6.006	22.728	23.033
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	1.364	1.270	4.389	5.340	9.893	11.011	38.800	44.389
Të tjera	646	764	2.140	2.765	1.910	1.884	7.064	7.551

**Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë)**

	Itali		Spanjë		Kosovë		Gjermani	
	2017	2018	2017	2018	2017	2018	2017	2018
<b>Gjithsej</b>	<b>47.402</b>	<b>50.487</b>	<b>4.205</b>	<b>8.016</b>	<b>6.139</b>	<b>5.877</b>	<b>3.646</b>	<b>4.755</b>
Ushqim, pije duhan	2.035	2.616	298	368	680	691	453	383
Minerale, lëndë djegëse, ener. elek.	3.957	1.342	3.193	6.631	1.991	599	551	869
Produkte kimike dhe plastike	445	480	2	17	399	347	8	9
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	665	730	4	69	2	1	0	3
Prodhime druri dhe letre	1.743	2.024	2	283	111	140	31	46
Tekstile dhe këpucë	29.627	32.173	569	572	41	33	1.801	2.585
Materiale ndërtimi dhe metale	5.083	6.385	132	68	2.428	3.496	535	270
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	2.755	3.369	1	2	177	212	208	399
Të tjera	1.091	1.368	3	7	311	356	60	192

**Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë)**

	Itali		Gjermani		Turqi		Greqi	
	2017	2018	2017	2018	2017	2018	2017	2018
<b>Gjithsej</b>	<b>53.826</b>	<b>56.153</b>	<b>16.049</b>	<b>17.037</b>	<b>15.043</b>	<b>16.359</b>	<b>14.587</b>	<b>15.873</b>
Ushqim, pije duhan	5.596	5.792	1.233	1.480	1.918	1.890	4.393	5.019
Minerale, lëndë djegëse, ener. elek.	5.353	3.739	189	166	535	195	1.792	2.265
Produkte kimike dhe plastike	5.833	5.574	2.393	2.591	2.200	2.424	2.595	2.348
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	4.209	4.816	2	63	104	110	21	33
Prodhime druri dhe letre	1.933	2.276	212	234	918	959	786	944
Tekstile dhe këpucë	13.172	14.152	740	857	4.805	4.972	1.183	1.264
Materiale ndërtimi dhe metale	5.840	6.852	2.641	459	1.602	2.471	2.495	2.626
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	10.056	10.965	8.120	10.640	2.284	2.585	748	838
Të tjera	1.833	1.986	519	546	679	752	574	537

# Përkufizime

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të rieksportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Mbretëria e Bashkuar, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

## Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri